

 Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerzitet Prizrena “UKSHIN HOTI”	
Pranuar me dt.	28.01.2020
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-17



UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” PRIZREN

UNIVERSITY “UKSHIN HOTI” PRIZREN

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000

Prizren, Republika e Kosovës;

Tel. +381 (0) 29- 232 140;

Homepage: www.uni-prizren.com

**RREGULLORE E PROCEDURAVE VLERËSUESE PËR ANAGAZHIMIN E
 BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM NË UNIVERSITETIN “UKSHIN
 HOTI” NË PRIZREN**

Prizren, Dhjetor 2019



Në bazë të dispozitave ligjore të nenit 14, pika 3.4, e Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” (tutje referuar si Universiteti), Senati i këtij Universiteti në mbledhjen e mbajtur më: 11.11.2019 e miratoi:

Rregulloren e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunorëve të jashtëm

Neni 1

Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim rregullimin dhe përcaktimin e procedurave vlerësuese për angazhimin e bashkëpunorëve të jashtëm për mbajtjen e ligjëratave, përkatësisht ushtrimeve, provimeve, kolokfiumeve, konsultimeve dhe mentorimeve sipas nevojës.

Neni 2

Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj rregulloreje është neni 13, pika 2.2, dhe 2.3 e Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës dhe neni 47, pika 1.3, 1.8 dhe neni 48, pika 1.9 e Statutit të Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

Neni 3

Procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunorëve të jashtëm

Procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunorëve të jashtëm bazohen në nevojën e sigurimit të veprimtarisë së qëndrueshme të Universitetit “Ukshin Hoti”, në përputhje me obligimet e tij, me theks të veçantë në aktivitetet si në vijim:

1. Aktivitete mësimore (ligjëratë, ushtrime)
2. Aktivitete konsultative;
3. Mbajtje të provimeve, kolokfiumeve, në lëndët në të cilat angazhohen;
4. Mentorimin e temave të diplomës.

Neni 4

Periudha e angazhimit

1. Angazhimi i bashkëpunorëve të jashtëm bëhet për një semestër dimëror ose veror si dhe për 1 (një) vit akademik.
2. Kontrata për angazhim lidhet në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.



3. Staf i akademik i angazhuar ka për obligim që në kuadër të kontratës të mbaj provimet, të asistoj në provime, për të gjitha afatet brenda vitit akademik, përkatësisht tri afate të rregullta pas mbarimit të kontratës.

Neni 5

Konkursi për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm

1. Procedura e angazhimit bëhet nëpërmjet shpalljes së konkursit publik.
2. Përjashtim nga paragrafi 1, i këtij neni bëhet për kategoritë si në vijim:
 - Personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune.
 - Profesorët vizitorë nga vendet e tjera, të punësuar në Universitetet respektive (për një numër të caktuar të ligjëratave deri në një semester), angazhohen me vendim të Senatit.
3. Konkursi do të shpallet vetëm nëse brenda Universitetit "Ukshin Hoti" nuk ka personel akademik të mjaftueshëm brenda fushës përkatëse.
4. Konkursi për angazhim shpallet nga Senati me propozim të Fakultetit, të bazuar në nevojat e tij për ligjëratat dhe ushtrime.
5. Rektori, në raste të veçanta, me arsyetim të bazuar, mund të propozoj shpallje të konkursit.
6. Senatit bën shpalljen e konkursit për angazhim të personelit në Fakultetin e caktuar.
7. Konkursi duhet t'u referohet kushteve të kësaj rregulloreje.
8. Konkursi duhet të shpallet në faqen e Universitetit "Ukshin Hoti". Kohëzgjatja e konkursit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga dita e shpalljes.
9. Kandidatët të cilët aplikojnë duhet t'i dorëzojnë të gjitha dokumentet brenda afatit të konkursit në kopje fizike të noterizuara dhe në lidhje të fortë.
10. Fakultetin përkatës për secilën njësi akademike nëse aplikon.
11. Diplomat për gradat shkencore të fituara jashtë vendit do të merren në konsideratë vetëm nëse janë të nostrifikuara dhe të dorëzuara para mbylljes së konkursit, me përjashtim të kandidatëve me diploma të panostrifikuara në programet e gjuhës boshnjake, turke dhe programet studimore të gjuhëve të huaja (për shkak të specifikave) dhe nga Universitetet ose Fakultetet që kemi marrëveshje të bashkëpunimit.
12. Kandidatët të cilët mund të angazhohen nga Universitetet jashtë Republikës së Kosovës dhe që kanë thirrjen akademike në Universitetet amë duhet të noterizojnë diplomën e studimeve doktorale si dhe vendimin e thirrjes akademike.



Neni 6

Komisioni vlerësues

1. Brenda 5 (pesë) ditëve pas hapjes së konkursit, Dekani i Fakultetit thërret mbledhjen e Këshillit të Fakultetit, në të cilën merret vendimi për formimin e Komisionit Vlerësues.
2. Komisioni Vlerësues propozohet në nivel të departamentit të degës, me mundësi edhe në nivel të Fakultetit dhe aprovet në Këshillin e Fakultetit.
3. Komisioni vlerësues është organ me kredibilitet të lartë profesional, akademik dhe etik, i cili përbëhet prej tre (3) anëtarëve.
4. Komisioni Vlerësues përbëhet prej profesorëve në marrëdhënie të rregullt pune, anëtarë të degës, përkatësisht anëtarë të Këshillit të Fakultetit.
5. Komisioni dhe kryetari i komisionit caktohen nga Këshilli i Fakultetit.
6. Në mungesë të numrit të mjaftueshëm të profesorëve, si në pikën 4 të këtij neni, në përbërje të Komisionit Vlerësues mund të emërohen edhe profesorë të lëmisë përkatëse nga degët (programet) e tjera të njësisë së njëjtë akademike dhe nga Fakultetet e tjera, anëtarë të Këshillit të Fakultetit.
7. Administrata e Fakultetit duhet t'i ofroj të gjithë dokumentacionin e nevojshëm Komisionit Vlerësues.
8. Kryetari i Komisionit Vlerësues është i obliguar që të thërras mbledhjen e komisionit dhe, pas vlerësimit, në koordinim me anëtarët e tjerë, të hartoj raportin e vlerësimit.
9. Komisioni, gjatë hartimit të raportit vlerësues, ka për obligim zbatimin e dispozitave të Statutit, konkursit dhe të kësaj rregulloreje.
10. Komisioni Vlerësues ka për obligim shqyrtimin e aplikacionit të secilit prej kandidatëve të paraqitur në konkurs, dhe në lëndën përkatëse.
11. Komisioni Vlerësues ka për obligim që në raportin vlerësues t'i prezantoj të gjitha faktet relevante (në mënyrë tabelare), për të gjithë kandidatët e paraqitur në konkurs për lëndën përkatëse.
12. Komisioni Vlerësues mban përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe etike për vërtetësinë e të dhënave të shënuara në raportin e vlerësimit.



Neni 7

Kushtet për angazhim

1. Personat e angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm nuk marrin thirrje akademike. Angazhimi i tyre bëhet bazuar në procedurat specifike të përcaktuara në vazhdim të kësaj rregulloreje.
2. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjërata, kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:
 - 2.1. Të ketë gradën shkencore doktor i shkencave në lëmin përkatëse (për lëndët e arteve, ekuivalente me të). Kandidatët të cilët krahas thirrjes doktor i shkencave kanë edhe thirrje akademike të ligjëruesit ose profesorit, të fituar në një nga Universitetet publike, kanë përparësi për t'u zgjedhur.
3. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ushtrime, kandidatët duhet të plotësojnë këto kushte:
 - 3.1. Të kenë të përfunduar studimet master ose ekuivalent me të në lëminë përkatëse.
 - 3.2. Të ketë notën mesatare jo më të vogël se 8 (tetë), në të dy nivelet e studimeve, kur angazhohet për herë të parë.
 - 3.3. Të jetë jo më i vjetër se 28 (njëzetë e tetë) vjeç, kur angazhohet për herë të parë.
 - 3.4. Në përjashtim, kur nuk ka kandidat sipas pikës 3.1, dhe 3.2., kandidatët mund të angazhohen për ushtrime deri në moshën 40 (dyzet) vjeçare nëse kanë gradën Dr. Sc. dhe që plotësojnë kriterin e përcaktuar sipas alinesë 3.2. të këtij neni.
4. Në rastin kur më shumë se një kandidat për pozitën përkatëse i plotëson kriteret e pikës 2 përkatësisht 3 të këtij neni, përzgjedhja do të bëhet sipas këtij prioriteti:
 - ✓ *Kandidati me pervojë më të gjatë në fushën përkatëse;*
 - ✓ *Kandidati i gjinisë femërore (në kushte të barabarta);*
 - ✓ *Në rastet e tjera mbetet në diskrecionin e komisionit vlerësues dhënia e përparësisë së kandidatit të caktuar.*
5. Nëse asnjëri nga kandidatët e paraqitur në konkurs nuk i plotëson kushtet, sipas pikës 2 përkatësisht 3 të këtij neni, apo nëse nuk konkuron asnjë kandidat, konkursi rishpallet sipas procedurës së njëjtë të përcaktuar me këtë rregullore.
6. Pas rishpalljes së konkursit, vlersimi i kandidatëve bëhet sipas procedurës së poshtëshënuar:



- 6.1 Në mungesë të kandidatëve me gradën e doktorit të shkencave (Dr.sc.) dhe nëse brenda njësisë akademike nuk mund të sigurohet kandidati me gradën e magjistratit (Mr. Sc.) ose masterit (MA), i cili do të mund të angazhohej për mbajtjen e ligjëratave në lëndën e caktuar në përputhje me Statutin e Universitetit “Ukshin Hoti”, për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm, për ligjërata në nivelin bachelor mund të angazhohet kandidati me gradën Ma.Sc. ose MA duke i dhënë përparësi kandidatit që ka të regjistruara studimet e doktoratës. Për të njëjtin, Këshilli i Fakultetit nxjerr vendim për t’ia besuar lëndën nën përkujdesjen e një profesori në marrëdhënie të rregullt pune në fushën përkatëse.
7. Në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, nuk mund të angazhohen kandidatët të cilët kanë më shumë se një angazhim në marrëdhënie të rregullt pune apo honorar në institucione publike apo private me pagë primare e sekondare.
8. Në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, nuk do të lejohet rekrutimi apo angazhimi i kandidatëve brenda ndonjëres prej strukturave themelore organizative (departament, degë), nëse brenda atyre strukturave të njëjtit kanë marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjarë të ngushtë në relacionin prind- fëmijë, bashkëshort- bashkëshorte, vëlla- motër, motër- motër, vëlla- vëlla dhe anasjelltas).
9. Në bazë të nevojave dhe kërkesave të njësive akademike lidhur me angazhimin e stafit akademik me honorar, Këshilli i Njësive Akademike përkatëse mund t’i propozoj Senatit që mësimdhënësve të Universitetit që kanë fituar thirrjen akademike të Prof. Dr. dhe Prof. Asoc, të ju lejohet që pas pensionimit angazhim deri në moshën 70 (shtatëdhjetë) vjeçare pa procedura konkurimi.
10. Njësitë akademike të Universitetit kanë të drejtë angazhim të stafit akademik me tituj akademik ekuivalent me titujt e Universitetit nga Universitetet publike jashtë Republikës së Kosovës bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit sipas nevojave dhe kërkesave të njësive akademike pa ju nënshtruar procedurave konkurruese.

Neni 8

Afatet e vlerësimit dhe marrja e vendimit për angazhim

1. Komisioni i vlerësimit në afat prej 3 (tri) ditësh pas mbylljes së konkursit përgatit raportin vlerësues, të cilin Këshilli i Fakultetit e shqyrton në afat prej 7 (shtatë) ditësh pas mbylljes së konkursit.



2. Vendimi i Këshillit të Fakultetit së bashku me raportin e Komisionit Vlerësues sipas pikës 12 të nenit 6 të kësaj rregulloreje publikohet në web-faqen e Universitetit, ditën e shqyrtimit në Këshill të Fakultetit, në kohëzgjatje prej së paku 5 (pesë) ditësh.
3. Bazuar në vendimin e Këshillit të Fakultetit, pas përfundimit të shqyrtimit të ankesave, Dekani i Njesisë Akademike përkatëse i propozon Senatit për angazhimin e kandidatëve të përzgjedhur nga komisioni. Vendimin përfundimtar e merr Senati.

Neni 9

E drejta e ankesës

1. Njësitë akademike obligohen që të themelojnë Komisionin për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.
2. Komisioni i Ankesave i përbërë prej 3 (tre) anëtarëve emërohet nga njësitë akademike përkatëse.
3. Kandidatët e pakënaqur kanë të drejtë ankesë në komisionin për ankesa në Fakultetin përkatës, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së vendimit të Këshillit të Fakultetit.
4. Komisioni i ankesave më së largu 3 (tri) ditë pas përfundimit të afatit të ankesave shqyrton ankesën e kandidatit dhe harton raportin me propozim përkatës. Raportin e dorëzon në Këshill të Fakultetit. Këshilli i Fakultetit në afat prej 3 (tri) ditësh nga marrja e raportit duhet ta shqyrtoj propozimin dhe të vendosë për miratim ose refuzim të raportit të komisionit.
5. Ankesa në shkallë të dytë parashtrohet më së largu 5 (pesë) ditë nga dita e pranimit në dorëzim të vendimit të Senatit të Universitetit me të cilin pala konsideron se i është mohuar e drejta për angazhim.
6. Ankesa duhet të dorëzohet në Njësinë Akademike përkatëse, të njëjtat më pas dorëzohen në rektorat dhe shqyrtohen nga Komisioni i Ankesave në nivel të Universitetit, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e mbylljes së afatit të ankesave. Ankesa duhet të jetë e qartë dhe konkrete, gjegjësisht duhet të përfshijë të gjitha argumentet relevante më arsyeshmërinë e kontestit.
7. Senati i Universitetit në afat prej 5 (pesë) ditësh nga marrja e raportit të Komisionit të Ankesave në nivel të Universitetit duhet ta shqyrtoj propozimin dhe të vendosë për miratim ose refuzim të raportit të komisionit.
8. Pala ankuese duhet të njoftohet me shkrim lidhur me vendimin e Senatit, si shkallë e fundit administrative brenda Universitetit.



-
9. Kundër vendimit përfundimtar të Senatit, kandidatët mund të parashtrojnë ankesë në gjykatën kompetente.

Neni 10

Nënshkrimi i kontratës për angazhim

Pas aprovimit nga Senati të listës së kandidatëve të angazhuar, Rektori nënshkruan kontratat e të angazhuarve.

Neni 11

Të drejtat dhe obligimet

1. Kandidatëve të angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm nuk i takon e drejta në pushim vjetor dhe kompensimin e përvojës së punës.
2. Angazhimi sipas kësaj rregulloreje nuk nënkupton themelim të marrëdhënies së rregullt të punës e as pagesë me automatizëm gjatë periudhës për të cilën angazhohet.
3. Në rast të konkurrimit për themelim të marrëdhënies së rregullt të punës aplikohen dispozitat e Statutit të Universitetit "Ukshin Hoti" për pozitën përkatëse.
4. Kandidatët e angazhuar bartin përgjegjësi ligjore për mënyrën e shfrytëzimit të aseteve të Universitetit "Ukshin Hoti".



Neni 12

Dispozitat kalimtare

1. Dispozitat e kësaj Rregulloreje hyjnë në fuqi nga dita e miratimit nga ana e Senatit.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohen të gjitha rregulloret dhe vendimet me të cilat është rregulluar çështja e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm.

Kryesues i Senatit të Universitetit

Prof. Asoc. Dr. Ismet Temaj

